

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali/ Shefin e Komisarariatit të Fushë-Krujës Elton Shahinin e rrahin me shpulla në mes të rrugës në Durrës
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/25/skandali-shefin-e-komisariatit-te-fushe-krujes-elton-s-hahinin-e-rrahin-me-shpulla-ne-mes-te-rruges-ne-durres/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:21:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 11:09:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	59ce584568213049d2c06606d87c2b142bc2b32b15938c24d7c35b4fcf2c05d0
TEKSTI	8c5f72364113f68f0a4d7eae23d82feecb5e78a9fad4998c558dc9cedf84187a
PAMJA	7c5f88af355ccc75c9ba43de2ffcd504dd38a8f0609c61c9dd36d0c92ef9929f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c73c889f1ea8a9a0be7e771c2e41bbe20fb982cfd483dcddf4eda52b21308061
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c73c889f1ea8a9a0be7e771c2e41bbe20fb982cfd483dcddf4eda52b21308061>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

S kandali/ Shefin e Komisariatit të Fushë-Krujës Elton Shahinin e rrahin me shpulla në mes të rrugës në Durrës

Kryesore

Publikuar: 25/09/2026



DURRËS- Një situatë e rëndë ka ndodhur rreth një muaj më parë në Durrës, ku drejtori i Policisë së Fushë Krujës është dhunuar nga një qytetar, pas një konflikti që kanë pasur në lidhje me qarkullimin në rrugë. Elton Shahini ka qenë duke lëvizur me motor, në momentin kur një qytetar me të cilin po konfliktohet zbret nga makina dhe e qëllon me pëllëmbë, pas një konflikti verbal të ndodhur fillimisht mes tyre. Ngjarja është bërë publike nga ish-deputeti Myslim Murrizi, i cili thotë se shteti ka degraduar, pavarësisht arsyeve mbi të cilat ka ndodhur konflikti.

Në video dëgjohet që Shahini e shan qytetarin, dhe më pas ky i fundit sapo zbret nga makina i drejtohet shefit të policisë me fjalët: *kë shan nga roptë ti!*

SHEKULLI kontaktoi dhe me drejtorinë e Policisë së Durrësit, por konflikti në fjalë nuk ishte referuar nga ana e Shahinit, dhe duket se çështja është zgjidhur personalisht me qytetarin e përfshirë në konflikt.

POSTIMI

Me të lexuarat

Video /



Kryeagjentja Vlora Hyseni 'i fik radarin' zonzës Pretenca: Je shqiptarë /



Kryesplunia Vlora Hyseni filmoi politikanë dhe magistratë me dashnorët në hotel për men mandatin e radhës, përmbaresit privatë i besojnë sërish drejtimin e Durrësit



Durrësi arrestua në Rusi, zbulohet portreti i Shpëtim Aliut! 'Kumbari' që furnizonte...



Çfarë rrezikon Vlora Hyseni, nëse provohen akuzat e SPAK ndaj saj?



Kjo video tregon se ku është katandisur shteti.

Ky me motor, të cilin e rrahin në mes të rrugës në Durrës, para një muaji, “si gomarin në duhan”, është shefi i Komisarariatit të Krujës, Elton Shahini, dhe ish-shef i Komisarariatit Nr. 1 në Tiranë.

Ky që e rreh, siç duket, duhet të ketë “të drejtë”, se ndoshta i ka zënë rrugën, ose mund ta ketë “vartës”, nëse ky që e rreh është pjesë e “strukturave” që e kanë emëruar.

Ndoshta është edhe oficer i SHISH-it, të drejtuar nga Vlora Hyseni, dhe ka marrë “urdhër” që t’ia fikë “radarin” shefit të Komisarariatit të Krujës.

Ehhh, ku jemi katandisur!

Kur rrihet në mes të rrugës një shef komisaritati, vaj medet çfarë sigurie do t’u ofrojë kjo polici qytetarëve.

Dhe jo vetëm e ka rrahur, por, siç duket, nuk e ka lënë as të bëjë denoncim.

Bela e madhe kur je i emëruar dhe i promovuar nga klane të

pista apo bota e krimit: edhe të rrahin, edhe nuk të lënë të “qash”.

Me siguri, SHISH-i i Durrësit duhet të ketë “bërë” raport për këtë ngjarje “argëtuese” për qytetarët që ishin të pranishëm aty, në këtë moment “pikant”.

/shekulli.com

TAG:

Elton shahini

Të ngjashme

Kush është Gazim Bregu që ndërtoi vilën e Ahmetajt në Hamallaj, përfitoi 20 milionë euro nga rindërtimi, aferat e pandëshkuar e Tigris 23 milionë e...

Agim Kola i ‘Riviera 2008’ kapet duke vjedhur paratë publike me kryebashkiakun e Dibrës Rrahim Spahiu, pjesë e aferave me tenderat edhe Musa Selami

Kosova i largon, Shqipëria i “ngarkon”/ Jemi kthyer në makinë apo shtet “riciklimi”?

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email:

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.